

K O M U N I K A T E
LIDHUR ME REZULTATET E KEF REFERENDUMIT

Më 1 dhe 2 mars 1992 në Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë me sukses u mbajt Referendum i për Autonomi Territoriale Politike të Shqiptarëve në këtë rajon. Qytetarët në mënyrë mësovike dhe në atmosferë solemne iu përzgjegjën ftesës për Referendum. Në Preshevë dhe Bujanovc, qytetarët e shprehën yllnetin e lirë dhe të pa penguar. Ndërse në komunën e Medvegjës Referendum u zhvillua në kushte të jashtëzakonshme, megjë në disa vendlivime intervenuen organet e punëve të brendshme. Në fshatin Svirçë kur ishte në përfundim e sipër deklarimi i qytetarëve arritën milicionerët dhe arrestuan kryetarin e Këshillit votues, Behmet Veselin dhe anëtarin e Këshillit votues, Raif Baftiun, me që u pengua rrjedha normale e Referendumit. Gjithashtu në fshatin Tupallë pasi u krye Referendum i morën në bisedë informative qytetarët Zeqir Kadriu dhe Naman Ismajli. Pas Referendumit dukshëm është shtuar prezenca e patrollave policore në fshatrat e banuara me Shqiptarë në Medvegjë.


Në këto tri komuna, në 71 vendlivime votuan 37.17% qytetarë që paraqet 96,34% nga numri i përgjithshëm i votuesve Shqiptarë. Gjithashtu 6.423 qytetarë të këtij rajoni votuan në vendlivimet në Botën e Jashtme ku gjenden në punë të përkohshme edhe atë në Zvicër, Gjermani, Suedi, Danimarkë, Norvegji, Austri dhe Australi. Kjo do të thotë se në Referendum dolën 96,96% prej 45.014 qytetarëve Shqiptarë me të drejtë vote në këto tri komuna, kurse për Autonomi u deklaruan 99,94% të votuesve.

Lidhur me Autonominë Territoriale Politike të Shqiptarëve në Medvegjë, Bujanovc dhe Preshevë u deklaruan edhe 4.325 Shqiptarë të këtyre komunave që sot jetojnë në Kosovë dhe Maqedoni.

Rezultatet e këtij Referendumit tregojnë se Shqiptarët e këtij Rajoni i jepin përkrahje të plotë Kuvadit për Autonominë Territoriale Politike të Shqiptarëve në Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë me të drejtë bashkimi me Kosovën, prandaj mbetet që Kuvendi në të ardhmen të engazhohet në sendërtimin e vullnetit të shprehur me anë të Referendumit.

PRESHEVË, 4 MARS 1992



DR. IBRAHIM KADRIU


Ibrahim Kadriu